

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[ Data : 19.05.2017]

**Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Mela” shpk & “Alb Shpresa” shpk**

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksioni i rruges Lalez-Bize-Draç”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i rruges Lalez-Bize-Draç”**.

Kohëzgjatja: brenda 12 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 206.371.000 (dyqind e gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar për vitin 2017 është 41.274.000 (dyzet e një milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë) Lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 25.04.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"VARAKU E" SHPK 80% & "VELLEZERIT HYSA"	121,829,487
2	"MELA" SHPK 30.8% & "ALBSHPRESA" SHPK 69.2%	125,000,000
3	"B-93" SHPK 55% & "BAJRAMI N" SHPK 45%	149,215,431
4	"BE IS" SHPK 50% & "2T" SHPK 50%	153,453,260
5	"BITUPAVE LLC"	154,745,038
6	"AL ASFALT" SHPK 85% & "EURONDERTIM 2000"	163,793,989
7	"PE-VLA-KU" SHPK	169,179,333

8	"SHANSI INVEST" SHPK 44% & "LALA" SHPK 45% & "JODY COMPANY" SHPK 11%	173,207,169
9	"BIA CONSTRUCTION" SHPK 40% & "ALBSTAR"	177,627,292

Komisioni vendosi te mblidhet pasi te gjithë antaret, ne menyre individuale, te shqyrtojne dokumentat per kualifikim te paraqitur nga shoqerite.

Ne daten 08.05.2017 Komisioni I Vleresimit te Ofertave vazhdoi me proceduren e vleresimit te ofertave te operatoreve ekonomike pjesemarres.

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

**1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Varaku E” shpk (80%) dhe “Vellezerit Hysa” (20%) pasi:**

Shoqeria “Varaku E” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi sipas deklarates se puneve ne proces kryen aktivitet ne Kamenice – Korce nga muaji shtator 2016 dhe per kete vend te ushtrimit te aktivitetit nuk ka paraqitur document per shlyerjen e detyrimeve. Edhe deklarata e paraqitur per te plotesuar kerkesen 2.2.5 per kualifikim rezulton e pa vertete.

Shoqeria “Varaku E” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e nje inxhinieri ndertimi me profiling “struktura”, ndonese ka marre persiper punime betoni ne te gjitha strukturat.

Shoqeria “Varaku E” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi:

- Referuar deklarates per mjetet ka vetem tre kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton nga tete te kerkuar, nderkohe qe ka marre persiper 80% te gjithë punimeve.
- Referuar deklarates per mjetet ka vetem nje rrul per n/shtresat rrugore gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton) nga kater te kerkuar, nderkohe qe ka marre persiper 80% te gjithë punimeve.
- Referuar deklarates per mjetet ka vetem nje rrul asfalti hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton) nga dy te kerkuar, nderkohe qe ka marre persiper te gjithë punimet e asfaltimit.
- Referuar deklarates per mjetet nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje rruli asfalti me gome - gome (Kapaciteti 6 - 8 ton), nderkohe qe ka marre persiper te gjithë punimet e asfaltimit.

Shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi sipas deklarates se puneve ne proces kryen aktivitet ne Kavaje, Belsh dhe Vore nga viti 2016 dhe per keto vende te ushtrimit te aktivitetit nuk ka paraqitur dokument per shlyerjen e detyrimeve. Edhe deklarata e paraqitur per te plotesuar kerkesen 2.2.5 per kualifikim rezulton e pa vertete.

Shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi:

- Ka marre persiper punime germimi dhe nuk ka asnje ekskavator (Referuar deklarates per mjetet).

- Ka marre persiper mbushje ne trupin e rruges dhe nuk ka as grejder e as ekskavator (Referuar deklarates per mjetet).
- Ka marre persiper punime elektrike nder te cilat edhe vendosje shtyllash dhe nuk ka as vinc as ekskavator (Referuar deklarates per mjetet).

**2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “B 93” shpk (55%) dhe “Bajrami N” (45%) pasi:**

Shoqeria “B 93” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e disa puneve.

Punet e kryera per ujesjellesat nuk mund te merren ne konsiderate pasi jane punime te nje natyre te ndryshme nga puna qe prokurohet. Ne kete menyre vlere totale pa tvsh e puneve qe konsiderohen te ngjashme eshte 179.124.291 leke nga 227.008.100 leke qe duhet te kishte realizuar bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper.

Shoqeria “Bajrami N” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.10 per kualifikim (deklarimin e puneve ne proces) pasi nuk ka deklaruar punen “Zhvillimi i rrjetit shperndares 20 kv TM/TU ne Agjensine Elbasan, Loti 3 pjesa dyte” me vlere 120.562.316 leke pa tvsh, per te cilen eshte shpallur fituese ne daten 19.04.2017.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

**3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Be Is” shpk (50%) dhe “2T” (50%) pasi:**

Shoqeria “Be Is” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi sipas deklarates se puneve ne proces kryen aktivitet ne Librazhd nga muaji dhjetor 2016 e ne vazhdim dhe per kete vend te ushtrimit te aktivitetit nuk ka paraqitur dokument per shlyerjen e detyrimeve. Edhe deklarata e paraqitur per te plotesuar kerkesen 2.2.5 per kualifikim rezulton e pa vertete.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

**4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Lala” shpk (45%), “Shansi Invest” shpk (44%) dhe “Jody Company” shpk (11%) pasi:**

Shoqeria “Lala” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi objekti i ngjashem “Infrastruktura e qytetit Krume” me vlere te realizuar ne tre vitet e fundit (referuar faturave tatimore) 18.373.046 leke pa tvsh nuk eshte i mjaftueshem per te plotesuar kushtin. Si pjesetar i bashkimit me vleren me te madhe (45%) duhet te kishte paraqitur nje objekt me vlere jo me pak se 103.185.500 leke pa tvsh. Objektet e tjera te deklaruar jane ujesjellesa, dhe si te tille nuk mund te konsiderohen si pune te ngjashme.

**5. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “BIA Construction” shpk (40%) dhe “Alb Star” shpk (60%) pasi:**

Shoqeria “BIA Construction” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi objekti i ngjashem “Reconstruction of ring road 1 Maji

Himare” eshte realizuar nga shoqeria “Gjikuria” shpk. Per nenkontraktimin e ketij objekti nuk eshte marre miratimi i investitorit dhe, ne kete menyre, nenkontraktimi konsiderohet ne kundersizim me ligjin.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Mela” shpk & “Alb Shpresa” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **125.000.000 (njqind e njezet e pese milion)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **11.05.2017**.

Per proceduren nuk jane paraqitur ankesa.

